



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" Durrës

Nr. 344 Prot.

Durrës, më 28.08 2026

Lënda: Njoftim për levizje paralele.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit". si edhe në udhëzimin nr 4 datë 4.03.2026 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr 759 datë 30.09.2024.

Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin

1- Pozicioni: - Përgjegjës i bazës prodhuese (Kontabilitet Financë)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

1. Kriteret e përgjithshme: Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- b) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- c) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

- d) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- e) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- f) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteret e posacme si vijon

2.Kritere të posacme për përgjegjësin e bazës prodhuese:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit "Master shkencor" (ose të barasvlershme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar";
- c) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit;
- d) të ketë përvojë pune të paktën 5 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale të njërës prej drejtimeve mësimore të ofruesit publik të AFP-së.

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a) letërmotivimin për pozicionin; b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të këtij udhëzimi ; c) kartën e identitetit; d) diplome/a; e)librezë pune; f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim ; g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h) vërtetimi të gjendjes shëndetësore; i) vërtetim të gjendjes gjyqësore; j)vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi; k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.


Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit në Shkollën e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda afatit _____.____.2026 të aplikimit të përcaktuar në shpallje.

3.Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 27.5.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI



Adresa:Lagja Nr.16 Rruga "Mbreti Gent" Durrës

e-mail:hcelamp@yahoo.com